Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada –Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, dt. 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 15 paragrafi 3 Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, dt. 12 qershor 2009,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/2011
PËR MASAT DHE KRITERET E PËRKRAHJËS NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2011

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen parimet për zbatimin e masave të miratuara për vitin 2011 në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës - PZHRB 2007 – 2013 si dhe përcakton kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat e përkrahjes.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë domethënie:

1.1 **"Kërkesa për pagesë"** nënkupton parashtrimin e kërkesës për mbështetje;
1.2 **"Ristrukturimi i potencialit fizik të sektorit agro-rural"** – nënkupton Masën 2 të PZHRB-së 2009-2013;
1.3 **"Përkrahje"** – nënkupton përkrahjen financiare për zbatimin e Masës 2 dhe 8 të PZHRB-së 2009-2013;
1.4 "**Përkrahja e grupeve lokale të veprimit** " nënkupton masën 8 të PZHRB-së 2009-2013
1.5 **"Aplikanti i parë – shërbehet i pari"** – nënkupton që aplikanti i parë që plotëson kriteret do të jetë përfituesi i parë.

Neni 3
Sektori dhe kushtet e përgjithshme për përkrahje

1. Përkrahja sigurohet për masat që synojnë ristrukturimin e potencialit fizik të sektorëve agro – rural dhe Grupeve Lokale të Veprimit si vijon:
   1.1 Ekonomit bujqësore - prodhues të qumështit;
   1.2 Ekonomitë bujqësore - prodhuese të vezëve;
   1.3 Pemë, perime dhe vreshta-rrush tryeze;
   1.4 Grupet Lokale të Veprimit.
2. Përkrahja sigurohet vetëm për investime të pranueshme në sektorët e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Përkrahja sigurohet nëse investimi do të jetë në përdorim nga përfituesi për një periudhë së paku (3) tre vjeçare pas finalizimit të investimit.

Neni 4
Aplikantët

1. Aplikantë mund të jenë personat fizik apo juridik, si dhe ndërmarrjet e regjistruara të cilët i përmbushin kriteret e pranueshmërisë për masat individuale.
2. Personat fizik, duhet të kenë vendbanim të përhershëm dhe të jenë shtetas të Republikës së Kosovës ndërsa personat juridik dhe ndërmarrjet tjera për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, duhet ti jenë të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Neni 5
Përkrahja financiare

1. Përkrahja financiare është e përcaktuar sipas nenit, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij udhëzimi administrativ.
2. Nëse buxheti në dispozicion nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet e të gjitha aplikacioneve të pranueshme. Aplikantët do të përzgjidhen sipas radhës së aplikacioneve të pranuara Qasja ”Aplikanti i parë – shërbehet i pari”, me kusht që ai ti plotësoi kriteret sipas këtij udhëzimi administrativ.
3. Përkrahja paguhet vetëm për shpenzimet e paraqitura pas miratimit të kërkesës për pagesë, duke dokumentuar shpenzimet me fatura valide.

Neni 6
Shpenzimet e papranueshme

1. Shpenzimet e papranueshme për të gjithë përfituesit e përcaktuar në nenin 9, 10, 11 dhe 12 të këtij udhëzimi administrativ janë:
   1.1 Taksat, duke përfshirë edhe TVSH;
   1.2 Taksat e doganës dhe importit ose ndalesat tjera;
   1.3 Blerja, qiratë ose lizingun e tokës ose ndërtesave ekzistuese;
   1.4 Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
   1.5 Shpenzimet për blerjen e pajisjeve të përdoruara;
   1.6 Ndalesat bankare, shpenzimet e garancive dhe ndalesat e ngjashme;
   1.7 Shpenzimet për operim dhe mirëmbajtje;
   1.8 Shpenzimet e bëra para publikimit të procedurës përkatëse të tenderimit dhe
   1.9 Shpenzimet në mall.

2. Përjashtimisht dispozitave të përcaktuara në paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të këtij neni, TVSH është e pranueshme për Grupet Lokale të Veprimit.

Neni 7
Përgatitja dhe zbatimi i programit

1. Përgatitja e programit për përkrahje vjetore dhe monitorimi i zbatimit të tij është përgjegjësi e Autoritetit Menaxhues të Ministrisë. Programi për përkrahje miratohet nga Ministri.
2. Programi i përkrahjes përbëhet nga një analizë e gjendjes së tanishme, prioriteteve dhe masave për strategjinë, përshkrimi i masave dhe kushteve - kriteret e pranueshme, plani financiar për zbatim, metoda e zbatimit, mekanizmat e zbatimit, monitorimi, vlerësimi i ndikimit të masave të zbatuara dhe mekanizmat për sigurimin e transparencës.
3. Zbatimi administrativ/teknik i këtij programi përkrahës është përgjegjësi e Njësisë së Pagesave në kuadër të MBPZHR-së.
4. Njësia e pagesave i aplikon procedurat administrative teknike për zbatim të programit, përgatit raporte me shkrim të cilat i'a dërgon Autoritetit Menaxhues dhe Ministrit për miratim.

II. Masat për përkrahjen e ristrukturimit të potencialit fizik në sektorin agro-rural për vitin 2011

II.1 Investimet në ekonomitë bujqësore prodhuese të qumështit

Neni 8
Kriteret e pranueshme për sektorin e qumështit

1. Përfituesit, duhet të kenë kafshë të shënjuara me matrikull të Republikës së Kosovës dhe të posedojë Listën e verifikimit të gjedheve për çdo krerë të lëshuar nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë - AUV.
2. Përfituesit, duhet të kenë (15) pesëmbëdhjetë, ose më shumë krerë të lopëve qumështore vazhdimisht.
3. Përfituesit, duhet të kenë kontrata me qumështoret ku ata dorëzojë qumështin.
4. Përfituesit, duhet të sjellin dëshmi të posedimit të të paktën 0,5 hektarë tokë punuese – të pranueshme janë toka që mbillet dhe livadhet për një krerë. Sipërfaqja e tokës mund të jetë në pronësi apo e kontraktuar së paku për (3) tri vite.
5. Përfituesit, duhet të dëshmojnë ndërtimin e tyre përmes:
   1.1 Lejes së ndërtimit të lëshuar nga organi kompetent i komunës;
   1.2 Pëlqimi i komunitetit në mjedisin ku planifikohet ndërtimi i stallës dhe
   1.3 Vlerësimi i ndikimit mjedisorë.
6. Ministria përgatit projektin e stallës sipas kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

Neni 9
Investimet e pranueshme për sektorin e qumështit

1. Investimet e pranueshme për këtë nën – masë janë:
   1.1 Ndërtimi i stallës sipas standardeve të aprovuara nga MBPZHR me këtë infrastrukturë të brendshme si vijon:
      1.1.1 Grazhdet për të ushqyer;

1.1.2 Sistemi për furnizim me ujë dhe ujë pirëset;
1.1.3 Vendqëndrimet për kafshë të rritura;
1.1.4 Dyert me dimensione gjerësi 3 m. dhe lartës 2.8 m. copë 2;
1.1.5 Dritaret me dimensione 80 cm. X 120 cm. pozicioni horizontal;
1.1.6 Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës;
1.1.7 Sistemi i ventilimit;
1.1.8 Dhoma e qumështit pa infrastrukturë të brendshme dhe
1.1.9 Vendqëndrimet për viça.

1.2 Pajisje për mjelje, ftohje dhe dhoma e qumështit, si vijon:
1.2.1 Sistemet e mbyllura të mjeljes;
1.2.2 Pajisje për ftohje të qumështit – laktofrizë;
1.2.3 Dhoma e qumështit, duhet të këtë:
1.2.3.1 Dyshemenë e shtruar me pllaka;
1.2.3.2 Mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m;
1.2.3.3 Sistem të ujit të pijes.

1.3 Pajisjet për përgatitjen e ushqimit të koncentruar dhe racioneve të kafshëve:
1.3.1 Mullinjtë për bluarjen e drithërave;
1.3.2 Përzierëset e ushqimit të koncentruar dhe
1.3.3 Makinë për përzierjen e ushqimit të koncentruar dhe voluminoz, me kapaciteti: 3 m^3, 5m^3 dhe 8$m^{3.}$

1.4 Pajisje për përgatitjen e ushqimit voluminoz - mekanizëm përcjellës i traktorëve mbi 30 kuaj fuqi, si vijon:
1.4.1 Makina për balosje në formë kubike ;
1.4.2 Makina për balosje rrotoballë;
1.4.3 Makina për silazhim 1 dhe 2 rendësh;
1.4.4 Makinë për ç'veshje të misrit;
1.4.5 Makineri për shpërndarje të plehut - rimorkio me sistem për shpërndarjen e plehut.

1.5 Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:
1.5.1 Sistemet për grumbullimin dhe deponimin e plehut të stallës, sipas standardeve të MBPZHR;
1.5.2 Depo për silazh - sistemi horizontal sipas standardeve të MBPZHR dhe
1.5.3 Depo për ushqimit voluminoz - hangarë sipas standardeve të përcaktuara nga MBPZHR.

2. Dokumentacioni i nevojshëm me një përshkrim të shkurtër, si vijon:
2.1 Përshkrimin e gjendjes në fermë;
2.2 Qëllimin e investimit;
2.3 Koston e investimeve të përgjithshme;
2.4 Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës - për personat fizike ose kopjen e regjistrimit të biznesit për persona juridik, dokumentin i cili vërteton se kush ka autoritetin që të nënshkruaj për kompaninë;
2.5 Kopjen e llogarisë së vlefshme bankare;
2.6 Dëshminë kadastrale të sipërfaqes së tokës së punueshme me përjashtim të të dhënave kadastrale për pyjet, kopshtet etj. që nuk janë tokë bujqësore në posedim ose kopjen e kontratës që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës bujqësore së paku për tri vite pas aplikimit;

2.7 Kopjen e kontratës për dorëzimin e qumështit në qumështore e nënshkruar dhe e verifikuar;

2.8 Kopjen e listës së verifikimit të gjedhëve të lëshuar nga Sektori për Identifikim dhe Regjistrim - I & R në kuadër të Agjencisë Ushqimit dhe Veterinës - AUV për të gjitha gjedhet – lopët qumështore;

2.9 Lejen e ndërtimit, lëshuar nga organi kompetent i komunës;

2.10 Pëlqimin e komunitetit në mjedisin ku planifikohet ndërtimi i stallës dhe

2.11 Dëshminë e vlerësimit të ndikimit mjedisorë.

3. Intensiteti i ndihmave

3.1 Kufiri më lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit në ndërtimin e stallës sipas nenit 8 paragrafi 1 të këtij udhëzimi administrativ është 25.000 €. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 50%. Ndihma financiare - granti për përfituesit është 12.500 €.

3.2 Kufijtë më të ulet dhe më të lartë të shpenzimeve të pranueshme të investimit janë:

3.3.1 Më së paku 10.000€ dhe

3.3.2 Më së shumti 20.000€ sipas nenit 8 paragrafi 2 të këtij udhëzimi administrativ. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 50%.

3.3.3 Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të pranueshme të investimit janë:

3.3.3.1 Më së paku 10.000 €

3.3.3.2 Më së shumti 20.000€ sipas nenit 8 paragrafi 3 të këtij udhëzimi administrativ. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 50%.

3.3.4 Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të pranueshme të investimit janë:

3.3.4.1 Më së paku 5.000 € dhe

3.3.4.2 Më së shumti 10.000€ sipas nenit 8 paragrafi 3 të këtij udhëzimi administrativ. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 50%.

3.3.5 Kufijtë më të ulet dhe më të lartë të shpenzimeve të pranueshme të investimit janë:

3.3.5.1 Më së paku 5.000 € dhe

3.3.5.2 Më së shumti 10.000€ sipas nenit 8 paragrafi 5 të këtij udhëzimi administrativ. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 50%.

Neni 10
II. 2. Ekonomitë bujqësore - prodhuese të vezëve

1. Përfituesit të kësaj mase janë personat fizik ose juridik të cilët duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për personat fizik ndërsa për personat juridik të jenë regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës.

II.2. Kriteret e përzgjedhjes

1. Shtrirja gjeografike tërë territori i Republikës së Kosovës.
2. Kriteret e pranueshme për sektorin e prodhimtarisë së vezëve, duhet që përfituesit do të kenë 3.000 e më shumë krerë të pulave vojse në prodhimtari aktive.
3. Investimet e pranueshme për sektorin e prodhimit te vezëve për këtë nën masë janë:
   1.1 Infrastruktura e brendshme e stallës;
   1.2 Sistemet e ventilimit;
   1.3 Sistemet e ujit brenda në fermë;
   1.4 Mekanizmi për largimin e plehut në fermë;
   1.5 Kafazet për vendosjen e pulave;
   1.6 Makinë për klasifikimin e vezëve;
   1.7 Dhoma frigorifer.
4. Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë, duhet të ketë sistemet për deponimin e plehut të stallës - gropa septike.
5. Dokumentacioni i nevojshëm, si vijon:
   1.1 Projekt propozimi me përshkrim të shkurtër;
   1.2 Përshkrimin e gjendjes në fermë;
   1.3 Qëllimin e investimit;
   1.4 Koston e investimeve të përgjithshme;
   1.5 Kopjen e certifikatës së biznes të regjistruar;
   1.6 Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar;
   1.7 Kopjen e llogarisë së vlefshme bankare;
   1.8 Dëshmi mbi origjinën e pulave - fatura e furnizimit;
   1.9 Dëshmi mbi gjendjen shëndetësore të pulave të lëshuar nga Autoriteti kompetent;
   1.10 Fotokopjen e certifikatës për trajnim relevante/specifike, ose të dëshmojnë në formë të shkruar e do të vijojnë trajnimet përkatëse brenda afatit të përmbylljes së projektit.

II. 2. Intensiteti i ndihmave

1. Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të pranueshme të investimit për fermat me mbi 10.000 krerë pula vojse janë:
   1.1 Më së paku 10,000 € dhe
   1.2 Më së shumti 20,000 €.
2. Nëse shpenzimet e investimit të pranueshëm janë më të larta se 20,000€ atëherë përfituesit, duhet të ofrojë mjetet e veta financiare për t'i mbuluar shpenzimet.
3. Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të pranueshme të investimit për fermat me 3.000 deri në 10.000 krerë pula vojse janë:
   1.1 Më së paku 5,000 € dhe
   1.2 Më së shumti 10,000 €.
4. Nëse shpenzimet e investimit të pranueshëm janë më të larta se 10,000 € atëherë përfituesit, duhet të ofrojë mjetet e veta financiare për t'i mbuluar shpenzimet. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 50%.

Neni 11

II. 2 Ristrukturimi i potencialit fizik të sektorit të pemëve, perimeve, dhe rrushit të tryezës

II .2.1 Sektori i pemëve

1. Sa i përket nen-masës së pemëve investimet gjerësisht mbulojnë pemishtet e reja si dhe zëvendësimin e pemishteve të vjetra, si dhe modernizimi i pajisjeve - makinerisë për kultivim në fermë me qellim të përmirësimit të efikasitetit në fermë.

II.2.2 Përfituesit

1. Në përgjithësi përfituesit për këtë masë janë persona fizik dhe juridik. Ata, duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për personat fizik ose janë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës për personat juridik.
2. Kriteret e përzgjedhjes për pemët është tërë territori i Republikës së Kosovës.

II.2.3 Kriteret e pranueshëm për sektorin e pemëve, janë si vijon:

1.1 Fermerët, duhet të dëshmojnë se posedojnë tokë bujqësore, toka mund të jetë në pronësi të fermerit ose e kontraktuar për shfrytëzim;
1.2 Fermerët, duhet të ngritin së paku 0,50 ha deri 5 ha pemishte të reja me mollë;
1.3 Sipërfaqja minimale e secilës ngastër pemishtet e reja që ngritën me mollë, duhet të jetë 0,50 ha.
1.4 Fermerët, duhet të ngritin së paku 10 deri 20 ari me pemë të imëta dredhëz, mjedër dhe manaferrë.

II.2.4 Investimet e pranueshme për sektorin e pemëve, janë si vijon:

1.1 Ngritja e pemishteve të reja me kulturën e mollës për prodhim intensiv pemishtet e reja që ngritën, duhet të jenë të kompletuara me infrastrukturë përcjellëse si:
    1.1.1 Sistemi i ujitjes pikë - pikë;
    1.1.2 Sistemit të mbajtës dhe
    1.1.3 Rrethoja.
1.2 Ngritja e pemishteve të reja me kulturën e mollës për prodhim intensiv;
1.3 Investimet në infrastrukturën e fidanishteve për prodhimtarin intensive të fidanëve si rrethoja dhe sistemi i ujitjes pikë – pikë tek fidanishtet ekzistuese;
1.4 Mbjellja e pemëve të imëta si dredhëz, mjedër dhe manaferrë;
1.5 Investimet në infrastrukturën e pemishteve ekzistuese për të gjitha llojet e pemishteve jo më të vjetra se tre vite, si sistemi i ujitjes, sistemi mbajtës dhe rrethoja e pemishtes;
1.6 Pajisje për spërkatjen e pemëve, atomizerë tërheqës dhe mekanizëm për plehërim.

II.2.5 Dokumentacioni i nevojshëm

1. Projekti investues, duhet të përmbajë:
    1.1 Përshkrimin e gjendjes në fermë;
    1.2 Qëllimin e investimit;
    1.3 Koston e investimeve të përgjithshme;

1.4 Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës për personat fizik ose kopja e regjistrit të biznesit për personat juridik, dokument që dëshmon fuqinë nënshkruese për ndërmarrjen;
1.5 Kopja e llogarisë së vlefshme bankare;
1.6 Fletën poseduese mbi sipërfaqen e tokës;
1.7 Kopjen e planit për investimin e bërë, ngritjen e pemishtes apo serës;
1.8 Dëshminë se janë furnizuar me material fidanor të mollës nga kompania -subjekti që është i licencuar si prodhues i materialit fidanor të pemëve nga MBPZHR-përkatësisht DPMB;
1.9 Dëshminë mbi gjendjen shëndetësore te materialit fidanor i importuar-certifikatën fitosanitare;
1.10 Dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore;
1.11 Fotokopjen e certifikatës për trajnim relevante-specifike, ose të dëshmojnë në formë të shkruar e do të vijojnë trajnimet përkatëse brenda afatit të përmbylljes së projektit.

II.2.6 Intensiteti i ndihmave për sektorin e pemëtarisë për kulturën e mollës

1. Investimet e pranueshme të pemishteve të reja me kulturën e mollës për prodhim intensiv pa infrastrukturë përcjellëse është si vijon:
   1.1 Minimumi i investimeve 3000€ dhe
   1.2 Maksimumi 6000€/ha.
2. Investimet e pranueshme minimumi i investimit 6000 € për ngritjen e 0,50ha pemishte, shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 3000 € për 0.50 ha pemishte.
3. Investimi për ngritjen e 1ha pemishte me mollë është 12.000 €, shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 6000 € për 1 ha pemishte me mollë.
4. Maksimumi i investimit është 60.000€ për ngritjen e 5 ha me pemishte. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 30.000€ për 5 ha pemishte. Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme përfituesi, duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.
5. Kufijtë me të ulët dhe lartë të shpenzimeve të kostos së investimeve të pranueshme në infrastrukture te pemishtet ekzistuese me molle - jo me të vjetra se tri vite janë, më së paku 3.000€ dhe më së shumti 6.000€ për 1 ha. Nëse shpenzimet janë më të larta se 6.000€ për 1 ha, atëherë përfituesi, duhet të japë mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.
6. Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të investimeve të pranueshme në makineri janë:
   1.1 Më së paku 3.000€ dhe
   1.2 Më së shumti 5.000€.
7. Nëse shpenzimet janë më të larta se 5.000€, atëherë përfituesi, duhet të japë mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

II. 2.7 Intensiteti i ndihmave për sektorin e pemëtarisë për pemë të imta dredhëz, mjedër dhe manaferrë

1. Investimet e pranueshme, minimumi i investimit 2000€ për ngritjen e 0.10 ha me kulturën e dredhëzës, mjedrës dhe manaferrës.
2. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 1000 € për 0.10 ha.

3. Maksimumi i investimit 4.000 € për ngritjen e 0.20 ha me kulturën e dredhëzës, mjedrës dhe manaferrës.
4. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 2.000 € për 0.20 ha.
5. Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme përfituesi, duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.

II.2: Sektori i perimeve

1. Përfituesit

1. Përfituesit për këtë masë janë persona fizik dhe juridik.
2. Ata, duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për personat fizik ose janë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës për personat juridik.

2. Kriteret e pranueshme për sektorin e perimeve, janë si vijon:

1.1 Fermerët, duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës bujqësore;
1.2 Toka mund të jetë në pronësi të fermerit ose e kontraktuar për shfrytëzim;
1.3 Fermerët, duhet të investojnë në ngritjen-ndërtimin e serrave të reja në një sipërfaqe prej 500m^2 deri 2000 m^2;
1.4 Fermerët mund të rrisin kapacitetet me serra të reja në një sipërfaqe prej 500m^2 deri 2000 m^2 .

3. Investimet e pranueshme për sektorin e perimeve, janë si vijon:

1.1 Ndërtimi i serrave të reja;
1.2 Zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese me serra të reja;
1.3 Tipet e serave të cilat mbështeten - përkrahen janë:
1.3.1 Serrat e tipit "Tunel" nga polietileni, sipërfaqja prej 500 m²;
1.3.2 Serrat e tipit "Bllok" nga polietileni, sipërfaqja prej 500 - 2000 m².

4. Blerja e makinerisë së specializuar bujqësore për kultivimin e perimeve në fushë të hapur si :

1.1 Makineria për përgatitjen e shtretërve për qepë dhe karrota;
1.2 Makineria për mbjelljen e qepës dhe karotës me farë;
1.3 Makineria për shtrirjen e plastmastit të zi.

5. Dokumentacioni i nevojshëm

1. Projekti investues, duhet të përmbajë:
1.1 Përshkrimin e gjendjes në fermë;
1.2 Qëllimin e investimit;
1.3 Koston e investimeve të përgjithshme;
1.4 Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës për personat fizik ose kopja e regjistrit të biznesit për personat juridik, dokument që dëshmon fuqinë nënshkruese për ndërmarrjen;
1.5 Kopja e llogarisë së vlefshme bankare;
1.6 Fletën poseduese mbi sipërfaqen e tokës;

1.7 Kopjen e planit për investimin e bërë, ngritjen e pemishtes apo serës;

1.8 Fotokopjen e certifikatës për trajnim relevante/specifike, ose të dëshmojnë në formë të shkruar se do të vijojnë trajnimet përkatëse brenda afatit të përmbylljes së projektit.

6. Intensiteti i ndihmave për sektorin e perimeve

1. Investimet e pranueshme për këtë nën masë janë:

1.1 Minimumi i investimit 10.000€ për ngritjen e serës prej 500 m^2, shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 5000 € për 500 $m^{2.}$ dhe

1.2 Maksimumi i investimit 40.000 € për ngritjen e serës prej 2000 m^2 , shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 20.000 € për 2000 m^2.

2. Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme përfituesi, duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.

3. Kufijtë më të ulët dhe të lartë të shpenzimeve të investimeve të pranueshme në makineri janë:

1.1 Më së paku 3.000€ dhe

1.2 Më së shumti 5.000€.

4. Nëse shpenzimet janë më të larta se 5.000€, atëherë përfituesi, duhet të japë mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

2. Sektori i vreshtave – rrush tryeze

1. Përfituesit

1. Në përgjithësi përfituesit për këtë nën masë janë persona fizik dhe juridik.

2. Ata, duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për personat fizik ose janë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës për persona juridik.

2. Kriteret e përzgjedhjes për vreshta për rrush tryeze, janë si vijon:

1. Nën-rajoni jugor – rajoni i vreshtave:

1.1. Rahovec;

1.2 Prizren;

1.3 Gjakovë;

1.4 Suharekë, dhe

1.5 Malishevë.

2. Nën-rajoni verior – rajoni i vreshtave:

1.1. Pejë;

1.2 Istog, dhe

1.3 Klinë.

3. Kriteret e pranueshme për rrush tryeze

1. Fermerët, duhet të dëshmojnë se posedojnë tokë bujqësore, toka mund të jetë në pronësi të fermerit ose e kontraktuar për shfrytëzim.

2. Fermerët, duhet të ngritin së paku 0,50 ha deri 2 ha vreshta të reja për rrush të tryezës. Sipërfaqja minimale e secilës ngastër, duhet të jetë 0,5 ha.

4. Investimet e pranueshme për vreshtari, janë si vijon:

1.1 Ngritja e vreshtave të reja për rrush të tryezës 0.50 ha deri 2.0 ha;
1.2 Investimet në infrastrukturën e vreshtave ekzistuese për te gjitha llojet e vreshtave si sistemi i mbajtës dhe rrethoja e vreshtit në vreshtat e reja jo më të vjetra se dy vite;
1.3 Pajisje për spërkatje të vreshtave, atomizerë tërheqës, mekanizëm për plehërim.

5. Dokumentacioni i nevojshëm

1. Projekti investiv, duhet të përmbajë më së paku:
   1.1 Përshkrimin e gjendjes në fermë;
   1.2 Qëllimin e investimeve;
   1.3 Koston e investimeve;
   1.4 Fotokopjen e letërnjoftimit valid të Republikë së Kosovës për personat fizik ose kopjen e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
   1.5 Dokumenti që dëshmon se kush e ka fuqinë e nënshkrimit për ndërmarrjen;
   1.6 Fotokopjen e xhirollogarisë bankare valide;
   1.7 Dëshmitë kadastrale për sipërfaqen e tokës së punueshme me të dhënat e kadastrave për pyje, oborre etj. që nuk janë tokë bujqësore, në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore së paku për tri vite pas aplikimit;
   1.8 Numrin identifikues të fermerit Vreshtar i cili nxirret në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave;
   1.9 Skica kadastrale e ngastrës, duhet të nxirret në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec;
   1.10 Fotokopjen e certifikatës për trajnim relevante/specifike, ose të dëshmojnë në formë të shkruar se do të vijojnë trajnimet përkatëse brenda afatit të përmbylljes së projektit.

6. Intensiteti i ndihmave

1. Investimet e pranueshme për këtë nen mase janë:
   1.1 Minimumi i investimit 4000€ për ngritjen e 0.50 ha rrush tryeze. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 2000€ për 0.50 ha rrush tryeze;
   1.2 Investimi për ngritjen e 1 ha me vresht për rrush tryeze është 8000 €. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 4000€ për 1 ha rrush tryeze;
   1.3 Maksimumi i investimit 16000€ për ngritjen e 2ha me vresht për rrush tryeze. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 8000€ për 2 ha rrush tryeze;
   1.4 Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme përfituesi, duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.
   1.5 Kufijtë me te ulët dhe të lartë të shpenzimeve të investimeve të pranueshme në infrastrukturë të vreshtat janë:
      1.1 Më së paku 3.000€ dhe
      1.2 Më së shumti 6.000€.
   1.6 Nëse shpenzimet janë më të larta se 6.000€, atëherë përfituesi, duhet të japë mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

Neni 12
Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal
Masat e programit të GLV

1. Përfitues të kësaj mase janë komuniteti lokal në viset rurale.
2. Kriteret e përzgjedhjes, janë si vijon:
   1.1 Tërë territori i Republikës së Kosovës; dhe
   1.2 Projektet të cilat kanë karakter ndërkufitar.
3. Përfituesit e mundshëm, janë personat juridik – GLV, të cilët janë të regjistruar në regjistrin e OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike.
4. Lloji i investimit të pranueshëm, janë si vijon:
   1.1 Infrastruktura bujqësore dhe rurale;
   1.2 Rregullimi i oborreve shkollore – rrethoja, ujësjellësi, fontana, parku i shkollës, hapja e puseve, fusha sporti;
   1.3 Rregullimi i parqeve që është i nevojshëm për rregullimin e parkut, duke përfshirë edhe këndin e lojërave për fëmijë;
   1.4 Rregullimi i varrezave që është i nevojshëm për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, duke përfshirë edhe rregullimin e infrastrukturës rrugore deri tek varrezat;
   1.5 Rregullimi i shtratit të lumit dhe kanaleve të ujitjes;
   1.6 Ndërtimi i ndonjë ure me interes të përgjithshëm;
   1.7 Rregullimi i rrugëve rurale dhe fushore me karakter të përdorimit të gjerë;
   1.8 Mirëmbajtja dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në zonat rurale;
   1.9 Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura;
   1.10 Përkrahja e ekspozitave me karakter bujqësor;
   1.11 Përkrahja e projekteve me karakter zhvillimor ndërkufitar.
5. Kostot e pranueshme janë të gjitha ato që janë të faturuara prej kompanive të cilat janë të angazhuara për kryerjen e aktiviteteve.
6. Dokumentacioni i nevojshëm, si vijon:
   1.1 Përshkrimin e gjendjes ekzistuese në teren;
   1.2 Qëllimin e investimit, arsyeshmëria, përfitimi nga investimi;
   1.3 Koston e investimeve të përgjithshme;
   1.4 Certifikatën e regjistrimit të GLV-së;
   1.5 Kopjen e llogarisë së vlefshme bankare në emër të GLV-së;
   1.6 Dëshmia e sigurimit të 30% të investimeve nga kuvendi komunal, komuniteti, biznesi privat – dëshmia nga kryetari i komunës ose përgjegjësi në sektorin financiar nga biznesi privat bartësi i biznesit, bankës, kompanisë ose nga komuniteti me nënshkrim të gjithë të interesuarve;
   1.7 Dëshmia e shlyerjes së obligimeve të anëtarësisë ndaj rrjetit të GLV-ve.

7. Intensiteti i ndihmave

1. Shpenzimet e projektit të pranueshme janë: minimumi 5,000€ dhe maksimumi 10,000€.
2. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuara të projekteve janë 70%.
3. Nëse shpenzimet e investimeve të pranueshme janë më të larta se 10.000€, atëherë mbi këtë shumë përfituese, duhet të ofrojnë mjetet e veta financiare për ti mbuluar shpenzimet.

Neni 13
Thirrja për aplikim

1. Thirrja për aplikim për të gjithë përfituesit e përcaktuar në nenet 8, 9, 10, 11 të këtij udhëzimi administrativ, do të jenë të hapura 45 ditë nga data e publikimit.
2. Procedimi i aplikacioneve behet si pas parimit i pari që aplikon i pari shërbehet nëse i plotëson kriteret e përcaktuara me këtë udhëzim administrativ.
3. Investimi, duhet të kryhet në afat maksimal prej 90 ditëve nga data e aprovimit të projektit. Nëse investimi kryhet para afatit të përcaktuar mund të behet kërkesa për pagesë të gjitha pagesat mbi shumën 500 €, duhet të behën përmes transferit bankar.

III Procedurat për zbatimin e projekteve

Neni 14
Procedurat

1. Procedurat për ofrimin e përkrahjes sipas këtij udhëzimi administrativ zbatohen përmes dorëzimit të aplikacioneve, shqyrtimit administrativ të aplikacioneve dhe kontrolleve në teren - vendngjarje.
2. Parashtruesi i kërkesës, duhet të filloi investimin pas marrjes së letrës informuese për pranimin e investimit nga Ministria.
3. Zbatimi i procedurave administrative bëhet sipas Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative.

Neni 15
Njoftimi publik

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural bën shpallje publike për hollësitë e masave të aplikuara për vitin 2011.

Neni 16
Dorëzimi i aplikacioneve

1. Aplikacioni për mbështetje dorëzohet në dy kopje brenda afatit sipas shpalljes publike, me dokumentacionin e kërkuar në Njësitë komunale përkatëse për bujqësi.
2. Njësitë komunale përkatëse për bujqësi pas pranimit të kërkesave për aplikim i'a dërgojnë Ministrisë për shqyrtim.
3. Formulari i aplikimit mund të merret në Njësinë komunale përkatëse për bujqësi dhe në Web faqen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Aplikacioni dorëzohet personalisht nga aplikanti ose i autorizuari i tij.

5. Aplikanti me nënshkrimin e tij siguron që të gjitha informatat e dhëna janë të qarta dhe të sakta dhe se ai do të lejon kryerjen e kontrollit në teren.

Neni 17
Shqyrtimi i aplikacioneve

1. Aplikacioni do të regjistrohet në regjistrin e aplikacionit, duke shënuar datën dhe kohën e dorëzimit.
2. Njësia komunale përkatëse për bujqësi e kontrollon se a është i kompletuar aplikacioni.
3. Aplikanti pranon një konfirmim për dorëzimin e aplikacionit në të cilin përfshinë datën e saktë, kohën e dorëzimit si dhe numrin e regjistrimit.
4. Nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar, afati shtesë për kompletimin e tij është (5) pesë ditë nga data e aplikimit.
5. Nëse aplikacioni nuk është i kompletuar edhe pas afatit shtesë prej pesë (5) ditësh të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni atëherë aplikacioni do të refuzohet nga Njësia komunale përkatëse për bujqësi.
6. Njësitë komunale përkatëse për bujqësi do t'i dërgojnë aplikacionet e kompletuara në Njësinë e pagesave jo më vonë se pesë ditë pas datës së aplikimit.

Neni 18
Verifikimi i kritereve të përzgjedhjes

1. Verifikimi i kritereve të pranueshmërisë do të përbëhet nga Ministria – Njësia e pagesave, kontrolli administrativ dhe kontrolli në teren që do të ndërmerren për të gjitha aplikacionet për miratim dhe për kërkesat për pagesa do të mbulojë të gjitha elementet relevante.
2. Verifikimi i kritereve të përzgjedhjes do të behet sipas procedurave të shkruara për kontrollin administrativ, kontrollin në teren, rezultateve të verifikimit dhe masave të ndërmarra lidhur me mospërputhjet.
3. Aty ku është e aplikueshme, verifikimi i kritereve të pranueshmërisë do të merr parasysh rezultatet e verifikimeve të bëra nga shërbimet tjera, trupat apo organizatat e përfshira në kontrollet e grandeve.

Neni 19
Procedurat e kontrollit dhe shqyrtimi i ankesave
Afati për shqyrtim, refuzimet, kompletimi i dokumentacionit, kontrolli administrativ dhe kontrollit në teren

1. Njësia e Pagesave do të kryejë kontrollin administrativ dhe kontrollin në teren të aplikuesve.
2. Nëse aplikacioni nuk është komplet, Njësia e Pagesave i dërgon aplikantit kërkesë për informata shtesë brenda një afati të caktuar.
3. Nëse aplikanti nuk i përgjigjet kërkesës brenda afatit të caktuar pesë (5) ditësh, Njësia e Pagesave refuzon aplikacionin.

4. Procedimi administrativ do të kompletohet brenda një periudhe prej 90 ditësh nga regjistrimi me një letër informuese mbi përkrahjen në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative. Në letër informuese, duhet paraqitur kushtet e mëtejme për operimin e miratuar.

Neni 20
Kërkesa për pagesa

1. Përfituesit që kanë përfunduar investimin do të dorëzojnë kërkesën për pagesë në Njësinë komunale përkatëse për bujqësi
2. Formulari i kërkesës për pagesë i sigurohet përfituesit nga Njësia komunale përkatëse për bujqësi.
3. Kërkesa për pagesë me dokumentacionin përkrahës dorëzohet personalisht nga përfituesi ose nga personi i autorizuar nga përfituesi jo më vonë së 15 ditë kalendarike, pas përfundimit të investimit siç përcaktohet në letrën informuese mbi përkrahjen.
4. Nëse kërkesa për pagesë nuk është komplete atëherë bëhet një kërkesë për plotësimin e kërkesës për pagesë dhe i dërgohet përfituesit brenda afatit prej 7 ditësh pune.
5. Pas afateve të përcaktuara në paragrafët 3, dhe 4 të këtij neni kërkesat për pagesë do të refuzohen.
6. Nëse projekti ndryshon qëllimin fillestar të kërkesës së përgjithshme për pagesë atëherë kërkesa, duhet refuzuar.
7. Pas zhvillimit të kontrolleve administrative dhe kontrolleve në teren mbi pranueshmërinë e kërkesës për pagesë atëherë Njësia e Pagesave lëshon një vendim mbi pagesën.
8. Pagesa kryhet në afat prej 30 ditësh nga lëshimi i vendimit mbi kërkesën për pagesë.

Neni 21
Dokumentacioni i kërkuar për pagesë

1. Pakoja e kërkesës për pagesë, duhet të përmbajë origjinalin e dokumenteve përkrahëse të kërkuara sipas kërkesës për pagesë, duke ja bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:
   1.1 Gjitha pagesat mbi shumën 500€, duhet të bëhen përmes transferit bankar dhe
   1.2 Pasqyrat bankare.
2. Nëse fatura është paguar me para të gatshme, atëherë në faturë, duhet shënuar fjala paguar dhe fatura të jetë e nënshkruar nga aprovuesi i saj. Veç kësaj, duhet siguruar një certifikatë ose dëftesë për pagesën e pranuar nga ofruesi i shërbimit.

Neni 22
Shkalla e kontrolleve në teren

1. Para vendosjes për mbështetje, Njësia e Pagesave obligohet të verifikojë përmbushjen e kushteve përmes kontrollit në teren në shkallë 100%.
2. Para kryerjes së pagesës, Njësia e Pagesave është e obliguar të verifikojë finalizimin e investimeve me anë të kontrollit në teren në 100% të kërkesave për pagesa.
3. Pas ekzekutimit të pagesës sipas vendimit për përkrahje zbatohet monitorimi në teren i 20% e përfituesve përfundimtar me qellim të verifikimit të afateve dhe kushtet e pranueshmërisë së grandeve, vazhdojnë të respektohen në një periudhë (3) tre vjeçare.

4. Në rast të kontestimit të vendimit për refuzim të kërkesës për pagesë nga fermeri, Ministria cakton një komision profesional për shqyrtim të ankesave.
5. Komisioni nga paragrafi 4 i këtij neni mund të vërtetoi, anuloi Vendimin e Njësisë së Pagesave apo mund të rekomandoi për superkontroll apo ri verifikim.
6. Ministria me vendim të veçantë e cakton komisionin për superkontroll – ri verifikim.

Neni 23
Sanksionet administrative

1. Në rast të çfarëdo parregullsie granti nuk jepet.
2. Në rast të mashtrimit apo shkeljes së dispozitave të këtij udhëzimi administrativ zbatohen sanksionet sipas nenit 38 Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
3. Përveç masës ndëshkimore nga paragrafi 2 i këtij neni, aplikantët përjashtohen nga çdo përkrahje publike gjatë tri (3) viteve të ardhshme.
4. Në rast të shkeljeve eventuale të kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ, Ministria me padi mund të inicioi procedurat gjyqësore pranë Gjykatës kompetente.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 18.04.2011

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Blerand Stavileci
_____